

VENDIM
Nr. 40, datë 1.6.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 15, datë 13.6.2012, “Për rinovim licence Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë”, me vlefshmëri 4-vjeçare deri në datën 13.6.2016.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë, me anë të shkresës nr. 45 prot., të datës 18.5.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës, shtim të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura, si dhe zgjerim të zonës së shërbimit.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekstraktin e QKB-së mbi emrin e subjektit, zgjerimin e zonës së shërbimit dhe shtimin e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë, me:
Drejtues ligjor dhe drejtues teknik: z. Hysni Breçani
 2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.
 3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Tropojë.
 4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani